

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.03.2021*

11.03.2021

Ora 12:11

RENDI I DITËS


Projektakti "Relatimi i kërkesës ankimore nr. 04, datë 09.03.2021 të znj.
Leonora Hyso ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.46, datë
09.02.2021".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:**

Z. I. Rusmali: Mirëdita! Të nderuar kolegë fillojmë seancën përgatitore për shqyrtimin e ankesës së zonjës Leonora Hyso, paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në datën 9 Mars të vitit 2021. Prezent në këtë seancë janë përfaqësuesit e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është edhe ankuesja Leonora Hyso e identifikuar rregullisht nga administrata në bazë të dhënave të kartës së saj të identitetit. KAS-i ka ftuar në këtë seancë edhe palën tjetër të interesuar zotin Rudi Pashai, këshilltar në Këshillin Bashkiak të Vlorës, i cili ka marrë dizeni është njoftuar, ka marrë dizeni për zhvillimin e seancës por nuk është paraqitur. KAS-i mund t'a zhvilloi seancën sepse nuk ka asnjë pengesë për zhvillimin e saj, kjo seancë më shumë për ankuesin është seancë përgatitore, ne nuk jemi duke shqyrtuar themelin e çështjes por ne po shqyrtojmë disa element të formës që janë të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të saj. KAS-i duhet përpara se të merret me çështjen duhet të shqyrtoj nëse është kompetent për trajtimin e saj, duhet të shqyrtoj sipas rregullave

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.03.2021*


të Kodit të Procedurës Administrative nëse ankuesja legjitimohet në paraqitjen e kësaj ankese, duhet të shqyrtojë elementët e formës së ankesës, duhet të shqyrtoj edhe çështje që kanë lidhje me afatin për paraqitjen e ankesës. Janë të gjitha kërkesa ligjore që shtrohen përpara nesh, përpara se ne të vendosim, të fillojmë të merremi me themelin e çështjes. Për këto gjëra mund të diskutojmë sot ose në këtë seancë. Jo për çështjet që janë shqetësimi juaj kryesor që i keni shkruar në ankesë. Por nëse ka ndonjë debat lidhur me kompetencën tonë për tu marrë me gjënë, nëse ka ndonjë diskutim për legjitimitimin tuaj, keni të drejtë ju të vini këtu apo jo, dhe nëse kërkesën tuaj, ankesën tuaj e keni paraqitur në afat ligjor apo jo, këto janë elementët që do të diskutojmë sot dhe ju do të keni mundësi të shpreheni sot për këto çështje. Administrata e KQZ-së e ka marrë e ka trajtuar, ju duhet të shpreheni paraprakisht për gjënë, apo t'ia jap fjalën ankueses unë?

Z. Y. Merkaj: Jo, thjesht ne mund të bëjmë vetëm kronologjin të ngjarjes.

Z. I. Rusmali: Në rregull një përshkrim të ngjarjes, Sekretari i Përgjithshëm një moment.

Z. Y. Merkaj: Në datën 22 Shtator 2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është njoftuar nga Këshilli Bashkiak Vlorë për krijimin e një vakance për shkak të dorëheqjes zotit Shkëlqim Leskaj një prej anëtarëve i Këshillit të Bashkisë Vlorë. Referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhor mandati i ndërprerë i anëtarit të Këshillit Bashkiak i kalon kandidatit vijues të së njëjtës parti politike për zgjedhjet në zonën zgjedhore përkatëse. Në rastin në fjalë kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste për Këshillin Bashkisë Vlorë, është kandidati me numrin rendor 51 zoti Rudi Pashai. Referuar ligjit të dekriminalizimit, vetëdeklarimi, verifikimi i formularit të vetëdeklarimit kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore që i kalon


*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.03.2021*

mandati i këshilltarit. Për këto arsye Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në datën 14 Tetor 2020 i ka kërkuar zotit Rudi Pashai të depozitojë formularin e vetëdeklarimit brenda 10 ditësh. Ku përmendet: “Nëse subjekti nuk e dorëzon brenda 10 ditësh atëherë, konsiderohet se e refuzon propozimin për kandidim në Këshillin e Bashkisë Vlorë”. Formulari i vetëdeklarimit i zotit Rudi Pashai nuk ka mbërritur ose ka mbërritur me vonesë, nuk ka mbërritur brenda afatit ligjor të përcaktuar 10 ditor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Për këtë arsye plotësimi i vakancës ose Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vijuar më plotësimin e vakancës me partinë tjetër të koalicionit pasi numri 51 i zotit Rudi Pashai ka qenë numri i fundit në listën shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të Këshillit Bashkiak. Brenda koalicionit hersi më i madh brenda të cilit konsiderohet që i takon mandati ka qenë Partia Demokracia Sociale ku kandidati i rradhës nga listat shumëmemërore e kësaj partie është zonja Leonora Hyso. Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka drejtuar zonjës Leonora Hyso kërkesën për të depozituar formularin e vetëdeklarimit, ku duhej të dorëzohej brenda 10 ditësh siç është edhe afati në rastin e parë. Në datën 17 Nëntor 2020 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ka mbërritur ankesa bashkëshoqëruar me formularin e vetëdeklarimit të zotit Rudi Pashai. Ku sqarohet se ky formular është plotësuar brenda afatit dhe është dorëzuar brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në shkresën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Por për shkak të mbylljes së postës herë pas here nga situata e pandemisë është vonuar dorëzimi i tij. Bashkë me ankimin dhe formularin deklarimit zoti Pashai ka sjellë edhe mandatin e postës që mban datën 20 Tetor 2020 që është brenda afatit 10 ditor që është kërkuar nga KQZ-ja. Për këto arsye, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur ndërprerjen e procedurës së verifikimit të zonjës Leonora Hyso dhe vazhdimin e procedurave për kandidimin ose dhënien e mandatit të kandidatit të parë zotit Rudi Pashai. Më datën 15 Dhjetor 2020 Komisioneri ka vendosur vazhdimin e procedurave dhe dhënien e mandatit zotit Rudi Pashai për plotësimin e vendit vakant.

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.03.2021*

Në dispozitivin e këtij vendimi është sanksionuar se kundër vendimit bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditësh nga shpallja e tij. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vënë në dijeni zonjën Hyso për ndërprerjen e procedurës së verifikimit me shkresën e datës 31 Dhjetor 2020. Në datën 7 Janar 2021 zonja Hyso ka kundërshtuar shkresën e datës 31 Dhjetor, ku informohet për ndërprerjen e mandatit duke pretenduar dyshime për manipulime procedurash për zënie afati nga zoti Rudi Pashai. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi ka shqyrtuar ankesën për zënie afatesh ka konkluduar se formulari i vetë deklarimit të zotit Rudi Pashai ka ardhur brenda afatit ligjor, vërtetuar kjo edhe me mandatin e postës. Këtë përgjigje Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve e ka komunikuar zonjës Hyso me shkresën e datës 15 Janar 2021. Në datën 8 Janar 2021 zonja Hyso ka bërë kërkesë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për t'u pajisur me kopjen e të dhënave të dokumentave që ndodhen në dosjen e kandidatit Rudi Pashai, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kthyer përgjigje kësaj shkresë me datën 15 Janar 2021 duke e informuar zonjën Hyso mbi vendimin nr. 30 të datës 15 Dhjetor 2020 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Si dhe duke i vënë në dispozicion kopjen e dokumentacionit të kërkuar nga zonja Hyso për dokumentacionin e paraqitur nga zoti Pashai. Në datën 9 Mars 2021 zonja Hyso ka paraqitur ankim pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për tek Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve duke pretenduar që ka manipulime procedurash për zënie afati të dorëzuar nga zoti Rudi Pashai. Në këto kushte çështja ka kaluar për shqyrtim Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Z. I. Rusmali: Faleminderit zoti Merkaj! Tani, ju keni të drejtën të na thoni qendrimin tuaj lidhur me këto çështje. Pra, jo me përmbatjen, keni ndonjë problem me ne, domethënë të na sqaroni çështjet e afatit kryesisht.

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.03.2021*

Znj. Leonora Hyso: Çështjet e afatit! Deri në fund të Dhjetorit ne nuk dimin gjë, ne prisnim që të merrnim mandatin si parti dhe si person, deri në datën 29 Dhjetor. Në datën 29 Dhjetor ka ardhur këtu zoti Skënder dhe ka pyetur dhe i kanë thënë: “ Jo, se e ka marrë Rudi Pashai”. Atëherë, na i jepni me shkrim! Na i dërguan me shkrim në datën 31 Dhjetor që erdhi në datën 5.

Z. I. Rusmali: Zoti Skënder kush është?

Znj. Leonora Hyso: Skënderi i partisë, sekretari i Partisë Demokratia Sociale, me Paskal Milon Kryetar.

Z. I. Rusmali: Në rregull!


Znj. Leonora Hyso: Në këtë shkresë më informonin që ju jeni hequr sepse Rudi ka pasur pengesa ligjore, ka pasur pengesa nga Posta Shqiptare për të ardhur në kohë. Në atë moment ne i kërkojmë edhe vendimin, sepse nuk e kishim vendimin, sepse nuk na kishte ardhur vendimi dhe nuk e dinim që kishte dalë vendimi në 15 Dhjetor sepse ne prisnim në emrin tonë, nuk dinim që kishte dalë...

Z. I. Rusmali: Pra, me datë 29 Dhjetor i keni kërkuar këto gjëra.

Znj. Leonora Hyso: Po, pse nuk po i jepet mandati Leonorës?! Atëherë, është dërguar me datën 15 Janar e gjithë dosja e Rudit po tek ne ka ardhur me datën 4, e kam edhe zarfin origjinal. Në datën 4 nga posta, tek Partia Demokratia Sociale ka ardhur në datën 4 Shkurt.

Z. L. Braho: Një pyetje me 31 Dhjetor çfarë i'u është komunikuar shkresërisht?

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.03.2021*

Znj. Leonora Hyso: Në datën 29 Dhjetor është komunikuar me gojë, verbalisht..

Z. L. Braho: Verbalisht..

Znj. Leonora Hyso: Që është hequr Leonora se ka ardhur prapë ai që ishte i Partisë Socialiste...


Z. L. Braho: Po me datë 31 keni marrë shkresërisht?

Znj. Leonora Hyso: Me datë 31 Dhjetor ne ja kërkuam gojarisht që na i dërgoni shkresërisht, me 31 Dhjetor kanë dërguar shkresën Leonorës që ju nuk...

Z. L. Braho: Që i'u është ndërprerë procesi.

Znj. Leonora Hyso: Po që i'u është ndërprerë procesi. Mirëpo në këtë ndërprerje nuk kishte vendim. Madje në këtë shkresë thuhet që do shikohet mandati i Rudit. Nuk thuhet që është bërë vendim, përsëri. Janë këtu shkresat! Megjithatë ne i kërkuam gjithë procedurën dhe na është nisur nga Komisioneri Shtetëror na ka ardhur, është nisur në 15 Janar dhe ka ardhur në 4 Shkurt tek ne, ja origjinalet. Në datën 4 Shkurt kur e lexuam i drejtohem i njërherë me një shkresë Komisionerit që ju thoni që ka pasur pengesa. Ne e dimë që nuk ka pasur, se posta ka punuar edhe në kohën e pandemisë së rëndë. Na jepni shkresën që keni verifikuar që Rudi është penguar nga Posta Shqiptare se ka pasur pandemi në kohën 15-30 Tetor 2020? Nuk dërguan dhe nuk kishin sepse dokumentet e Rudit janë këtu dhe nuk kishte. Detyrimisht si Parti Demokracia Sociale i'u drejtuam Postës Shqiptare dhe i thamë a ka pasur pengesa gjatë muajit 15-31 Tetor të vitit 2020? Edhe Posta Shqiptare na u përgjigj, në origjinal, fotokopjen e keni aty nuk ka pasur asnjëherë asnjë pengesë,

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.03.2021*

ka punuar rregullisht. Me këtë përgjigje, marrim mandatin që na është dërguar nga Komisioneri, mandatin e Rudi Pasha dhe i drejtohem Postës së Vlorës, postës qendrore, zyrtarisht si parti ju lutemi na njoftoni nëse ky mandat është i rregullt apo jo?! Sepse ne shikojmë që brenda saj ka shumë pikëpyetje dhe Posta e Vlorës na kthen përgjigje: “Ne e shqyrtoam kërkesën tuaj por nuk keni të drejtë që t’ua japin juve përgjigje, ka të drejtë vetëm zoti Rudi, KQZ ose të veni në gjygj”. Domethënë ne duhet ti drejtohem gjyqësisht. Ndryshe nuk zgjidhet ky problem, detyrimisht ne u ankuam për këtë sepse ka manipulim, mendojmë që ka manipulim mbase është fiksimi i joni, por po t’a shikoni mirë me vëmendje këtë që ka dërguar KQZ tek ne, themi që data... thotë që barkodi, barkodi është i fshirë dhe LM-në e bën barkod. Data 20.10 duket që ka manipulim se duhet të jetë 20.11 megjithatë këto gjëra janë të fshira dhe duken kështu me sy, edhe vula nuk është 20.10 por është i 11-ti.

Z. L. Braho: Të bëj një pyetje tjetër, jo për këtë. Këtë ankimin që i ke drejtuar Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve ju e keni sjellë me postë, çfarë date e keni depozituar? Këtë që po shqyrtojmë ne sot.

Znj. Leonora Hyso: Në datën 8.

Z. L. Braho: Në datën 8 Mars e keni postuar?

Znj. Leonora Hyso: Po!

Z. L. Braho: Në rregull.

Znj. Leonora Hyso: Dhe në datën 11 sot mua më thirrët të vij këtu.

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.03.2021*

Z. I. Rusmali: Tani, desha unë të bëj një pyetje tjetër. Ju kërkua mandatin e postës nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i'u është vënë në dispozicion?

Znj. Leonora Hyso: Po, po gjithë dosja e Rudi Pasha.

Z. I. Rusmali: Në ç'kohë?

Znj. Leonora Hyso: Kjo mban datën 15.01 por ne n'a ka mbërritur me postë në datën 4 Shkurt sepse ata venin dhe nuk i gjenin ata të partisë aty edhe detyrimisht pastaj kërkuan numrat e telefonit dhe pastaj e sollën. Jo se ishte posta, po nuk gjenin personat aty dhe shtyhej afati. Në datën 4 Shkurt ka ardhur. Urdhëroni ja ku e keni, madje ata kanë vajtur edhe tek Partia Demokratike, tek Partia Republikane... Urdhëroni u dorëzua në datën 04.02....

Z. I. Rusmali: Ja ta shoh.

Znj. Leonora Hyso: Kanë bërë shënime ata të postës.

Z. I. Rusmali: Në rregull, gjë tjetër lidhur me këtë ke për të thënë?

Znj. Leonora Hyso: Unë kam për dyshimet që ka aty....

Z. I. Rusmali: Jo, të lutem jo për dyshimet. Se dyshimet janë çështje themeli, e thelbit të gjësë. Për çështjen e afateve, domethënë ju gjykoni që në datë 4 Shkurt ju keni pasur dosjen e kompletuar të Rudi Pashait mbi të cilën ju mund të gjykonit dhe të bënit ankimin tuaj.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.03.2021*

Znj. Leonora Hyso: Më falni t'iu ndërpresë, bashkë me vendimin....

Z. I. Rusmali: Bashkë me vendimin, pra me 4 Shkurt....

Znj. Leonora Hyso: Na ka ardhur vendimi, bashkë me vendimin...

Z. I. Rusmali: Po pse e keni mbajtur deri më datë 8 Mars këtë gjë dhe me 8 Mars keni nisur ankimin?

Znj. Leonora Hyso: Po, sepse brenda në këtë dosje të Rudit nuk ekzistonte përgjigje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që Posta Shqiptare të kishte thënë që ka bllokim. Sipas thënieve të tyre Rudi Pashai është në rregull dhe e ka dorëzuar sepse ka pasur bllokim Posta Shqiptare. Atëherë, duke parë që nuk ishte kjo, i'u drejtuam Postës Shqiptare, e cila na ka dërguar përgjigje, ja përgjigja e postës, Laert Duraj. Urdhëroni! Nga kërkesa që i bëmë ne

Z. I. Rusmali: Dakord por është irrelevante çështja e postës tani, domethënë ju gjykuat që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet t'iu jepte juve dhe një vërtetim nga Posta Shqiptare, ku Posta Shqiptare konfirmonte, që ka pasur vonesa në korrespondencë.

Znj. Leonora Hyso: Jo, nuk ka pasur vonesa. Ka qenë shumë në rregull!

Z. I. Rusmali: Jo, jo dakord po....

Znj. Leonora Hyso: Nga këta? Po, po

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.03.2021*

Z. I. Rusmali: Nga këta. Edhe kjo nuk i'u erdhi kurrë?

Znj. Leonora Hyso: Po.

Z. I. Rusmali: Edhe kjo ishte pengesa që nuk mund të bënit ankimin në kohë.

Znj. Leonora Hyso: Ne duhet të bindeshim vetë për këtë punë njëherë pastaj të bënim akuza.

Z. I. Rusmali: Në rregull! Më fal, një pyetje për administratën. Në dosje ka të administruar ndonjë vërtetim nga Posta Shqiptare ku thuhet se ka pasur vonesa dhe për shkak të vonesave mund të kenë ndodhur gjëra të tilla? Ka apo nuk ka? S'ka rëndësi.

Z.Y. Merkaj: Jo, nuk kemi pasur sepse nuk e kemi ditur.

Z. I. Rusmali: Ju nuk keni pasur.

Z.Y. Merkaj: Nuk e kemi ditur. Në momentin që zoti Rudi Pashai ka dërguar ankesën ka thënë pse unë nuk po marr mandatin, dhe ka thënë unë e kam marrë brenda 10 ditësh dhe e ka dorëzuar brenda 10 ditësh dhe këtë e vërtetoi me mandatin e postës.

Z. I. Rusmali: E kuptova, do të thotë që ju nuk mund t'i dërgoni një dokument që ju nuk e dispononit, që nuk e kishit.

Z.Y. Merkaj: Jo. Në momentin që e solli Rudi Pashai i'a kemi vënë në dispozicion.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.03.2021*

Z. I. Rusmali: Por nuk keni dhënë as përgjigje që nuk e kemi një dokument të tillë çfarë kërkon nga ne pak a shumë?

Z.Y. Merkaj: Sepse nuk e dinim në momentin që...

Z. I. Rusmali: Në rregull. Po të lutem! Hape mikrofonin!

Znj. Leonora Hyso: Për këtë problem kur erdhi shkresa ne i jemi drejtuar përsëri Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke i thënë: “A keni marrë përgjigje nga posta”? Dhe nuk na është kthyer përgjigje fare nga këta. U detyruam që e drejtuam ne vetë ne pyetjen. Domethënë e kërkuam ne tek posta.

Z. I. Rusmali: Qartë, e kuptova! Pyetje nga kolegët?

Z. L. Braho: Kisha një pyetje për administratën e KQZ-së. Zoti Merkaj atë mandatin e postës që ka sjellë kandidati tjetër përveç datës që është data 20.10. 2020 keni bërë ndonjë verifikim të mëtjshëm në lidhje me afatin apo thjesht jeni mbështetur tek data që ka?


Z.Y. Merkaj: Thjesht nuk mund t’a gjykojmë ne.

Z. L. Braho: Po tek vulat tek origjinalja tek vula arrini të dalloni datë?

Z. I. Rusmali: Le të rrimë tek çështja e afateve mos t’i futemi përmbatjes, se tek përmbatja na hap pyetje të tjera pastaj.

Z.Y. Merkaj: Ne thjesht kemi parë data 20 Tetor dhe nuk e kemi diskutuar.

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.03.2021*

Z. K. Bele: Kisha një pyetje për legjitimitimin tonë për këtë ankesë, ndoshta do vazhdojmë me administratën dhe pastaj t'a shqyrtojmë. (Pa mikrofon, nuk dëgjohet!)

Z. I. Rusmali: Ne debatet për veten tonë i bëjmë në dhomë të këshillimit, nuk është se është ndonjë...

Z. K. Bele: Jo thjesht do i bëja një pyetje administratës për këtë.. (pa mikrofon, nuk dëgjohet!)

Z. I. Rusmali: Pyetje tjetër, ndonjë gjë lidhur për të sqaruar afatin? Afati është çështja thelbësore këtu.

Z. L. Braho: Unë doja që të administronim si provë edhe kopje të atij zarfi se tek kopja që kemi ne nuk është ai shënimi që është dorëzuar në 4 Shkurt. Dhe kopje të mandatit të postës që zonja i është drejtuar KAS-it që mban datën 8 sipas zonjës. Pra 8 Mars. Tek kopja e zarfit nuk e kemi me shënimin që është dorëzuar me 4 Shkurt letra e KQZ-së dhe po ashtu nuk kemi as mandatin e zonjës...

Z. I. Rusmali: Po, por si ka mundësi që nuk e kemi këtë gjë ne?

Z. L. Braho: Se mund të jetë bërë kjo fotokopje nuk e di.... Këto të dyja thjesht për ti administruar si provë.

Z.Y. Merkaj: Nuk e disponojmë atë zarf ne, se nuk kemi pse ta disponojmë. Pastaj ai është nisur nga KQZ, e thotë posta e keni nisur, ne thjesht e kemi nisur.

Z. I. Rusmali: Jo, e kemi disponojmë këtë. Me shënim e kemi këtë.

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.03.2021*

Z. Y. Merkaj: E keni, e keni me shënim e keni tek dokumentet.

Z. I. Rusmali: Adnand Selimaj posteri dhe diçka tjetër. Jo, jo e disponojmë.

Z. Y. Merkaj: Duhet t'a keni tek praktika që i'u është dorëzuar.

Z. I. Rusmali: Kërkesa ankimore vetë mban datën 8, është protokolluar në datën 9 në KQZ. Domethënë çfarë do na vërtetoi.... Datën 8 dhe datën 9 ne i kemi të fiksuara, data 8 është e dokumentit data 9 është e dorëzimit. Mirë, pyetje tjetër? Një pyetje kisha unë. Vendimi numër 30 është publikuar në faqen zyrtare, të KQZ-së. Ju e keni aksesuar faqen është publikuar? Ai mban datën 15 Dhjetor dhe është publikuar me datë 16 Dhjetor.

Znj. Leonora Hyso: Juve u'a sqarova që në fillim që ne ishim gjithmonë në pritje të vendimit.

Z. I. Rusmali: Jo, ju lutem atë e dëgjova me vëmendje. Pyetja që kam është: Jeni futur në faqen e internetit?

Znj. Leonora Hyso: Jo nuk jemi futur, nuk e di unë. Ishim të sigurtë që do na vinte...

Z. I. Rusmali: Nuk jeni futur, nuk keni pasur mundësi që juve të viheshit në dijeni nëpërmjet publikimit, pavarësisht se bënit kërkesë po se vendimi është gjithmonë i publikuar.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.03.2021*

Znj. Leonora Hyso: Keni shumë të drejtë sepse vendimin duke menduar që ne ishim në rregull dhe do të na vinte vendimi nuk i jemi futur asaj kështu, prisnim që të vinte vendimi gjithmonë në rrugë më shumë kështu me telefon...

Z. I. Rusmali: Dakord zonja Hyso, po ju keni bërë kërkesë në datë 7 Janar: “Na vini në dispozicion vendimin”.

Znj. Leonora Hyso: Vendimin nuk e kishim.

Z. I. Rusmali: Keni bërë kërkesë pra, i keni thënë KQZ-së na vini në dispozicion vendimin. Në datë 7 Janar edhe përpara edhe më mbrapa vendimi ka qenë i publikuar.


Znj. Leonora Hyso: Nuk e kemi pasur. Në datën 7 Janar kemi thënë dosjen jo vendimin, nuk e dinim fare që kishte dalë vendimi. Pra në datën 7 ne kemi thënë kërkojmë dosjen që si është emëruar zoti Rudi dhe brenda kësaj gjetëm vendimin. Të na kuptoni kështu është rrjedhoja e ngjarjeve.

Z. I. Rusmali: Në rregull. E kuptoj shumë mirë këtë gjë, desha të dija pse nuk e keni aksesuar dot nëpërmjet internetit vendimin.

Znj. Leonora Hyso: Ne do ta kishim goditur nëse qoftë se do të kishim dyshime dhe nuk ishim të bindur që do ta merrnim do t’a shikonim faqen nuk kishte ndonjë gjë. Por ishim të bindur që do ta merrnim edhe nuk e kemi parë. Atëhere kemi pritur këto, vetëm për këtë arsye.

Z. I. Rusmali: Dakord!

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.03.2021*

Znj. Leonora Hyso: Sepse edhe vendimi thotë 45 ditë. Po ne nuk e arrinim më atë sepse edhe atëhere u futëm në këto ndjekje në atë që nuk e kishte bërë KQZ e bëmë ne. Duke u bindur që e ka bërë posta, ka të drejtë që i është bllokuar?! Jo. Dhe këtë këtu n'a jepni një përgjigje është e rregullt kjo? Se kjo duket komplet që është e fshirë e kështu.

Z. I. Rusmali: Në rregull, ndonjë gjë tjetër?

Z. E. Lako: Kam edhe unë një pyetje. Aty vendimi i Komisionerit thotë që keni 45 ditë afat për t'iu drejtuar Gjykatës Administrative, ju e keni konsumuar Gjykatën Administrative?

Znj. Leonora Hyso: Po pikërisht për këtë po i'u themi që ne vendimin për herë të parë e kemi parë në datën 4 Shkurt.

Z. E. Lako: Ku e patë, tek dosja?

Znj. Leonora Hyso: Tek shkresat, tek dosja e Rudi Pashai.


Z. E. Lako: Po pse nuk i'u drejtuat Gjykatës Administrative po i'u drejtuat KAS-it?

Znj. Leonora Hyso: Sepse Gjykata Administrative e kishte mbaruar afatin e saj.

Z. E. Lako: Po KAS-i sa e ka afatin?

Znj. Leonora Hyso: KAS-i është më brenda problemeve se është këtu brenda Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili mund t'i shikoj më me imtësi dhe më me

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.03.2021**

korrektësi. Domethënë jo se nuk kam besim tek Gjykata Administrative, ne do kërkonim njëherë rivendosjen në afat sepse ka kaluar afati 45 ditësh. Është dhënë në 15 Dhjetor në 15 Janar -30 Janar. Ishim jashtë afatit do t'i futeshim një rivendosjeje pranohej nuk pranohej. Atëhere, i ramë komisionit për ankesa, pikërisht për këtë gjë.

Z. I. Rusmali: Në rregull. Pyetje të tjera? Nuk ka! Mirë ne tani për tani do t'a mbyllim këtu sepse kemi vetëm këtë çështje për të diskutuar, do konsultohemi me njëri -tjetrin si do t'i ndajmë gjërat, do të vendosim do t'a pranojmë këtë ankesë apo nuk do t'a pranojmë. Sigurisht që është detyrim ligjor që t'a kalojmë në këtë rrugë.... Kalimin për shqyrtim e drejtë, do ta pranojmë ta shqyrtojmë apo jo?! Prandaj nuk u morëm me çështjen, u morëm vetëm me këto elementet që kanë lidhje me formën ... Do na presësh besoj 20 minuta - gjysëm ore ndoshta.

Znj. Leonora Hyso: Unë pres edhe dy muaj vetëm për respekt ...

Z. I. Rusmali: Jo, jo vetëm kaq që ne mund të konsultohemi me njëri tjetrin edhe të marrim një vendim të pjekur dhe të ta komunikojmë sot vendimin.


Znj. Leonora Hyso: Faleminderit! Përpara se të merrni vendimin edhe dje në telefon zonjës Ina i kam thënë "Është e çuditshme që brenda 24 orësh ju njoftoni për një gjyq që ne vuajmë me vite të tëra, dhe po më habitni".

Z. I. Rusmali: Po habitesh për mirë apo për keq?

Znj. Leonora Hyso: Për mirë.

Z. I. Rusmali: Për mirë, shumë mirë. Kjo na kënaq!

**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.03.2021*

Znj. Leonora Hyso: Shumë faleminderit për këtë që keni bërë mjafton që u mblodhët dhe unë jam shumë e kënaqur dhe e lumtur. Unë nuk jam karrieriste në këtë moshë, mua më vlerësuan shumë dhe pastaj më vranë shumë. Domethënë kjo ishte e gjitha.

Z. I. Rusmali: Administrata e KQZ-së ka një punë shumë të vështirë në këtë periudhë, me shumë ngarkesë.

Znj. Leonora Hyso: Ke të drejtë është shumë e ngarkuar.

Z. I. Rusmali: Unë jam i sigurt që ata e çmojnë vlerësimin pozitiv sidomos për shkak të kësaj ngarkese që kanë në këtë periudhë. Mirë, do na presësh pak përjashta sa t'a shqyrtojmë dhe do të thërrasim vetë.

Znj. Leonora Hyso: Po, faleminderit!

Z. K. Bele: Nga verifikimi i vendimeve të Komisionerit në faqen e internetit që i nxorra, janë gati 30 vendime ose 29 vendime nga të cilat 21 kanë referuar si organ kompetent për ankesën Gjykatën Administrative dhe pastaj diku nga data 28 Dhjetor e deri sot përfshirë edhe vendimin objekt të këtij shqyrtimi administrativ, dhe nga data 28 dhe në vijim janë rreth 8 vendime. Nga një pyetje paraprake m'u tha që ka një ndryshim të qendrimit të Komisionerit lidhur me këtë çështje. Kemi ndonjë dokument apo opinion ligjor apo ndonjë dokument që mund të na ndihmonte si trup për të krijuar bindjen tonë pastaj sipas vendimmarrjes tonë lidhur me këtë çështje. Pra, ka ndonjë Memo ose ndonjë dokument të caktuar, të hartuar për këtë qëllim?

**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.03.2021*

Z.Y. Merkaj: Që kur ka hyrë në fuqi “Ligji i Dekriminalizimit” në vitin 2015 është bërë një mbledhje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i dikurshëm dhe në mbledhje është debatuar gjatë dhe është caktuar që kundër vendimeve që u bë për formularin e vetdeklarimit do të ankohen në Gjykatën Administrative të shkallës së parë dhe që nga ai moment është ndjekur kjo procedurë. Me ardhjen e Komisionerit të ri në momentin që ai e ka parë ose e ka verifikuar ose e ka gjykuar e ka ndryshuar.

Z. K. Bele: (Pa mikrofon, nuk dëgjohet!)

Z.Y. Merkaj: Me sa jam në dijeni unë thjesht komisioneri nuk e ka gjykuar ose e ka parë, ka vendosur me atë procedurën e dikurshme, më vonë e ka gjykuar, e ka menduar ka thënë meqë janë krijuar tre organe të reja në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të gjitha ankimet e Komisionerit do të bëhen në KAS.


Z. K. Bele: Faleminderit! Se ka bërë Gjykata Kushtetuese praktikë, kështu që nuk ka ndonjë gjë, nuk është erez. Thjesht kaq ishte pyetja ime. Faleminderit!

Z. I. Rusmali: Në rregull! Do na prisni edhe ju përjashta pastaj.

Rifillon Mbledhja ora 13:45.

Z. I. Rusmali: Atëhere, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve e shqyrtoi çështjen deri në këtë pikë në çështjen e seancës përgatitore. Ne, KAS-i vendosi që për shkak të domethënë, afati i ankimit për ju, në vlerësimin e KAS-it ka filluar që nga dita kur është bërë publik vendimi nr.30 datë 15 Dhjetor 2020. Do të thotë që nga data 16 Dhjetor 2020. Afati ligjor i ankimit është 30 ditë, kërkesa është paraqitur

**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.03.2021*

në datën 8 Mars do të thotë është paraqitur jashtë afatit ligjor të ankimit. Për këtë arsye KAS-i vendosi:

Të mos pranojë për shqyrtim të mëtejshëm këtë ankim mbështetur në nenin 136 të Kodit të Procedurave Administrative i cili nuk lejon organin publik që të shqyrtojë vendimin, ligjshmërinë apo përshtatshmërinë e një akti administrativ të ankimuar në qoftë se akti vetë është i pa pranueshëm për shkak se ndër të tjera paraqitet ankimi, domethënë ankimi vetë është i pa pranueshëm për shkak se paraqitet jashtë afatit. Ju do ta merrni vendimin tonë të zbardhur shumë shpejt besoj për një ose dy ditë sepse edhe ai ka nevoj për t'u punuar. Sigurisht gëzoni të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi në gjykatën kompetente që është Gjykata Administrative. Ky ishte vendimi ynë në formë të shkurtuar siç u'a thashë të detajuar do ta merrni nëpërmjet administratës. Ju faleminderit, mund të shkoni.

Vendimi nr.7

***Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI***

